



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I MINISTRAVE
KËSHILLI KOMBËTAR I TERRITORIT

V E N D I M

Nr. 5, Datë 22.08.2014

PËR

MIRATIMIN E LEJES ZHVILLIMORE TË VEÇANTË PËR ZHVENDOSJEN E
STATUJËS SË NËNË-TEREZËS

Në mbështetje të neneve 8 dhe 70/7 të Ligjit nr. 10119, datë 23.04.2009 “Për Planifikimin e Territorit”, i ndryshuar, të VKM-së nr. 502, datë 13.07.2011 “Për Miratimin e Rregullores Uniforme të Kontrollit të Zhvillimit të Territorit”, i ndryshuar, VKM-së nr. 877, datë 03.10.2013 “Për përbërjen e Këshillit Kombëtar të Territorit”, në kuadër të masave për vizitën e Papa Françeskut në Shqipëri, me propozimin e Ministrit të Kulturës, Këshilli Kombëtar i Territorit,

VENDOSI:

1. Miratimin e Lejes Zhvillimore të Veçantë:
 - “Për zhvendosjen e statujës së Nënë Terezës që ndodhet pranë aeroportit ‘Nënë Tereza’ për restaurim në Qendrën e Realizimit të Veprave të Artit”
 - “Për zhvendosjen e statujës së Nënë Terezës pranë Universitetit Politeknik të Tiranës në rrethrotullimin e Aeroportit “Nënë Tereza”
2. Materiali i plotë grafik bashkëlidhet si pjesë përbërëse e këtij vendimi.
3. Ngarkohet Ministria e Kulturës për zbatimin e këtij vendimi.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI

EDI RAMA

